



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:078051

Datë: 05.09.2019

Numri i dokumentit: 00494066

P. nr.190/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.P., nga Gjakova, për shkak të veprës penale të lëndim i lehte trupor nga neni 188/3nën.par3.1 lidhur me par.1 nën. par.1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.112/2019 të datës25.02.2019, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **06.08.2019** në prani të Prokurorit të shtetit Nazmi Krasniqi si dhe të akuzuarit A.P., te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.P.**, nga Gjakova, , i biri S. dhe i nënës Z. e gjinisë K., data e lindjes..., në Gjakovë ka te kryer shkollën fillore, punëtor, i gjendjes se dobët ekonomike, egjiptian, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar, numer personal...

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-me dt. 28.08.2018, rreth orës 13.55 min , në Rr. “M. M.”në Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë që ditën kritike gjersa i pandehuri po qëndronte së bashku me të dëmtuarin e mitur F.E., i cili në ndërkohë ia kishte marrë nga xhepi një pije dhe me të kuptuar këtë i njëjti i thotë “boll të kam duruar“, ku e godet me shuplaka dhe pasi i dëmtuari kishte shkuar në shtëpi sërish është kthyer duke e sharë me atë rast i pandehuri e godet me grushte në kokë dhe trup derisa është rrëzuar në tokë.

-me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehte trupor nga neni 188/3nën.par3.1 lidhur me par.1 nën. par.1.4 të KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë te nenit 4,41,43,49,50,51,73 të KPRK-ës dhe nenit 188par.3nën.par3.1 lidhur me par.1 nën. par.1.4 të KPRK-së, të KPRK-ës dhe nenit 365 te KPPK-së, të akuzuarit A.P. i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim me kohëzgjatje prej **3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari F.E., për të realizuar kërkesën e vet pasurore -juridike udhëzohen në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej **20.00** € si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **20.00 euro**, në afat prej **15 ditëve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.112/19 të datës 25.02.2019, ndaj të akuzuarit A.P. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/3 nën.par.3.1 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar me datë 06.08.2019, Prokurori shtetit Nazmi Krasniqi lexon aktakuzën PP.nr.112/19 dt.25.02.2019, me ç ‘rast prokurori deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, por sa i përket kualifikimit juridik me qene se nga akt ekspertimin mjeko ligjore i dt. 05.02.2019, rezulton se i dëmtuari ka lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshme të shëndetit , atëherë bëjmë precizimin e kualifikimit juridik të veprës penale që duhet të jete lëndim i lehtë trupor nga neni 188/3 pika 3.1 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-ës.

I akuzuari A.P., në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës ashtu siç kam deklarua edhe në st. policor se pari jam provokuar nga këtu i dëmtuari, pas provokimit i njëjti përveç ofendimeve me sharje edhe ka gjuajtur në drejtim timin për çka edhe në afekt edhe unë i kam gjuajtur .Me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, si dhe fakti se me të dëmtuarit familjarisht jemi pajtuar sipas traditave, i propozojë gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm ,gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin , të me shqiptojë një dënim më të but .

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova të mjaftueshme nga të cilët formohen të gjitha elemente e veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A.P.: -me dt. 28.08.2018, rreth orës 13.55 min , në Rr. “M.M.” në Gjakovë, tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm të shëndetit , në atë mënyrë që ditën kritike gjersa i pandehuri po qëndronte së bashku me të dëmtuarin e mitur F.E., i cili në ndërkohë ia kishte marrë nga xhepi një pije dhe me të kuptuar këtë i njëjti i thotë “boll të kam duruar “, ku e godet me shuplaka dhe pasi i dëmtuari kishte shkuar në shtëpi sërish është kthyer duke e sharë me atë rast i pandehuri e godet me grushte në kokë dhe trup derisa është rrëzuar në tokë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka

administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga i dëmtuari për lëndimin që i ka shkaktuar në afekt, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar nga ana e gjykatës. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **3(tre)** muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 të KPPK-së. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitivin e nenit 41 të KPPK-ës, se kjo do të ndikojë tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikojë tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.190/19 më datë 06.08.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2019:078051
Datë: 05.09.2019
Numri i dokumentit: 00494066